



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME / SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA / SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT
Pallati i Drejtësisë, Objekti A, Rruga Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palata Pravde, Objekt A, Ulica Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palace of Justice, Building A, Nekibe Kelmendi Street, 10510 Hajval

VËRTETIMI MBI DORËZIMIN E DOKUMENTIT

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pala e nënshkruar më poshtë vërteton pranimin e dokumentit:

Ndërmarrja: Preduzeće:Enterprise:

1. OLT Osijek

• Socially Owned Enterprise • Rahovec

POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA

Na osnovu Zakona br. 04/L-033 o Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju, dole potpisana stranka potvrđuje dostavu dokumenta navedenog dole:

Numëri i lëndës: Broj predmeta: Case Number:

C-IV.-22-0295

ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT

Pursuant to Law no 04/L-033 on Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters, the below signed party acknowledges receipt of the document described below:

Data e regjistrimit: Datum registrovanja: Date registered:

12/30/2022

Paditës
Tužilac
Claimant


I paditur
Tuženi
Respondent

Përfaqësues
Punomočnik
Representative

Përfaqësues
Punomočnik
Representative

#	Titulli i Dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document Name:	Datë Datum Dated
1	Aktvendim nga Dhoma	Rešenje komore	Decision of the Chamber	12/28/2022

Pala:	Stranka:	Party:
Pranuar nga:	Primio:	Received by: <u>AKP- PRISTINE</u>
Titulli:	Zvanje:	Title: _____
Data:	Datum:	Date: _____
Nënshkrimi	Potpis:	Signature: _____





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C-IV-22-0295

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit (AL),
i Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) “OLT OSIJEK”-Njësia Rahovec , (PRZ076) në likuidim,
Rahovec,
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), rr. “Dritan Hoxha” nr.55 Lakrishte, Prishtinë

Për: Parashtruesin e kërkesës

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 28 dhjetor 2022, lëshon këtë:

AKTVENDIM

1. **Aprovohet** Raporti Përfundimtar i AL të NSH “OLT Osijek” –Njësia Rahovec,
2. **Lejohet** mbyllja e rastit të likuidimit ndaj kësaj NSH-je.
3. **Lirohet** AL nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e ndonjë shpërndarjeje përfundimtare që nuk është realizuar ende.
4. Parashtruesi ka paguar taksen gjyqësorë.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 22 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme Raportin Përfundimtar të mbylljes së procesit të likuidimit të NSH “OLT Osijek”-Njësia Rahovec , në Rahovec , pasi që është ardhur në përfundim që ndërmarrja ne fjale nuk ka asete te realizueshme si dhe janë përmbushur te gjitha kërkesat kreditore te vlefshme ne baze te nenit 40 te ligjit 04/L-034 si dhe vërtetimit se nuk ka ankesa te regjistruara ne Dhomën e Posaçme, parashtruesi i kërkesës ka propozuar që konform nenit 43 te Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tutje: Shtojca e Ligjit të AKP-së) dhe ne pajtim me nenin 46 te këtij ligji , pas shqyrtimit të kërkesës të aprovojë Raportin Përfundimtar të NSH “OLT Osijek”-Njësia Rahovec dhe të merr vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj ndërmarrjeje.

Për detaje të tjera referoju dosjes së lëndës.



Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme, pas shqyrtimit të kërkesës, konstaton se kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Sipas nenit 43 paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti i Likuidimit.

Paragrafi 2 i nenit 43 përcakton se Raporti përfundimtar përmban:

- 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera,
- 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme,
- 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,... dhe
- 2.4. një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

Paragrafi 3 i shtojcës së Ligjit bazik po ashtu i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) përcakton se: *Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes.*

Neni 44 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

Autoriteti i Likuidimit ka dorëzuar Raportin Përfundimtar për aprovim përfshirë dëshmitë në vijim që janë shqyrtuar nga gjykata.

Me 30 janar dhe 14 shkurt 2017 Bordi i Drejtorëve të AKP-se ka nxjerr vendim për likuidimin e NSH-së. Po ashtu me 22 shkurt 2017 ka vendosur edhe për themelimin dhe përbërjen e Autoritetit të Likuidimit për këtë NSH, përbërja e të cilit kishte ndryshuar disa herë deri me 01 maj 2021. Emërimet e Autoritetit të Likuidimit (shtojca 4 e Raportit)

Me 08 mars 2017 Autoriteti i Likuidimit ka publikuar njoftimet e para për fillimin e procesit të likuidimit në gazetën Koha Ditore, Kosova Sot në Kosovë dhe gazeta Danas.

Me 21 mars 2017 njoftimi i dytë në gazetën Koha Ditore dhe Kosova Sot (**Shtojca 5** e Raportit)

Me 09 mars 2017, AL ka dërguar njoftimet përkatëse për fillimin e Likuidimit të kësaj NSH-je tek institucionet relevante :

Zyrën e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
Administratën Tatimore të Kosovës
KEDS



PTK

Hidrosistemi –Radoniqi Gjakove

KRM Ekoregjioni Prizren

KK Rahovec Drejtoria per Gjeodezi e Kadaster dhe Prone

MMPH Agjencise Kadastrale te Kosoves

Gjykatës Supreme të Kosovës dhe

Dhomës se Posaçme te Gjykatës Supreme

Gjykates se Apelit ne Prishtine- Departamentit Ekonomik

Gjykatës Themelore ne Prizren ,

Gjykatës Themelore ne Prizren dega Rahovec ,

Bankës Ekonomike Prishtinë

Procredit Bank

Raiffeisen Bank

NLB

Banka Private per Biznes

TEB Bank

Lista me kërkesat e parashtruara (shtojca 7)

Parashtruesi i kërkesës i ka bashkangjitur kërkesës edhe Listën e parashtruesve për kërkesat ndaj NSH-së, ku janë shënuar kodi i NSH-së, emri i parashtruesit të kërkesës, statusi i kërkesës, si dhe datat e dorëzimit të vendimit, po ashtu ka deklaruar se deri në muajin korrik 2022, Autoriteti i Likuidimit nuk ka pranuar ndonjë të dhënë që DHPGJS ka pranuar ndonjë ankesë. Dhoma e Posaçme ka konfirmuar se nuk ka ndonjë lëndë aktive me këtë ndërmarrje, përkatësisht ndaj kësaj NSH-je. (shtojca 13)

Kërkesës po ashtu i është bashkangjitur edhe Lista e asetëve të shitura, nga ku shihet se asetet të shitura janë Toka bujqësore dhe Ndërtesë administrative –Rahovec tokë në sipërfaqe prej 27,315.00 m2 dhe objekt me sipërfaqe prej 3.552.00 m2 te cilat janë shitur data e kontratës me 01 prill 2019, (Shtojca 9)

Parashtruesi ka deklaruar se sipas dokumenteve të gjetura në arkivin e NSH-së, nuk ka asete ndaj të cilave është hequr dorë. (shtojca 10)

Autoriteti i Likuidimit në bazë të Pasqyrës Përmbledhëse Financiare e llogarisë Bankare në likuidim (shtojca 11 në tabelën 1 dhe 3) ka deklaruar të ardhura/hyrje 921,104.73 €, nga të cilat në fondin e konsoliduar të Republikës së Kosovës janë transferuar 694,908.02 €.

Shpenzime tjera në tabelën 3 përfshijnë shumën prej 47,555.63 €, duke përfshirë: tarifa Administrative e Agjencisë shumën prej 44,444.40 €, shpenzimet e reklamimit, shpalljeve, sherbimet, shumën prej 1,133.45 €, shpenzimet e gjykates 721.50 €, pagesat e kreditorve shumën prej 1,256.28 €.



Ne baze te pasqyres permblledhese financiare te llogarise bankare ne likuidim (bazuar ne **shtojcën 11**) parat e mbetura ne llogari bankare jane 178,641.08 €.

Parashtguesi ka deklaruar se shuma e parave në mirëbesim të likuidimit, apo që gjinden në llogaritë rrjedhëse në bankë është 178,641.08 dhe se kjo shumë do të përdoret në të ardhmen për të mbuluar shpenzimet eventuale në lidhje me procedurat e mbylljes së NSH-së dhe pas përfundimit të këtyre procedurave, fondet e mbetura do të transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës. (**shtojca 16**).

Gjykata konstaton se Agjencia Kosovare e Privatizimit përkatësisht Autoriteti i Likuidimit i ka ndërmarr të gjitha veprimet dhe vendimet e nevojshme për mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je, në pajtim me ligjin, andaj aprovon Raportin Përfundimtar të NSH-së dhe lejon mbylljen e rastit të likuidimit të kësaj NSH-je.

Me këtë ndërpritet ekzistimi i kësaj ndërmarrje dhe rasti mbyllet.

AL mbetet më tej përgjegjës për veprimet apo lëshimet joligjore gjatë mandatit të tij, sipas nenit 46.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Parashtguesi i kërkesës, ka bërë pagesën e taksës gjyqësore dhe nuk caktohen taksa shtesë në këtë procedurë.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare

